



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 846/5 prot.

Datë 02.04.2026

V E N D I M

Nr. 460/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Kryetar
Anila Malaj	Anëtare
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.04.2026, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me nr. Elektronik A/2026/6427 dhe nr. 846/2026 prot, datë 17.03.2026, e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, **Numri i referencës së lotit të I-rë: REF – 78429-03-06-2026**, me objekt: “**Loti i I-rë:** Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi rrugës Arben Mekshi dhe Joklin Persi”, me fond limit: 984,993.50 (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 24.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK me NIPT K72113010E dhe adresë Rruga Mujo Ulqinaku, Objekti Nr.23, Z.1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Tiranë me adresë Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 09.03.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, **Numri i referencës së lotit të I-rë: REF – 78429-03-06-2026**, me objekt: “**Loti i I-rë:** Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi rrugës Arben Mekshi dhe Joklin Persi”, me fond limit: 984,993.50 (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 24.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2026/6427, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, **Numri i referencës së lotit të I-rë: REF – 78429-03-06-2026**, me objekt: “**Loti i I-rë:** Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi rrugës Arben Mekshi dhe Joklin Persi”, me fond limit: 984,993.50 (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 24.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumentave të tenderit, të paraqitur nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.3. Me shkresën me nr. 846/1 prot., datë 01.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor Bashkisë Tiranë, për të dhënë informacion mbi trajtimin e formularit të ankesës së operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK, në kuptim të ninit 114 të LPP-së.

II.4. Me shkresën nr. 213 prot., me datë 01.04.2026 protokolluar me tonën me shkresën nr. 846/2 prot, datë 01.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht pranë autoritet kontraktor ka paraqitur shkresë me bojekt “Kërkesë për tërheqje nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. Aplikimi online A/2026/6427 më datë 14.03.2026, me nr. Ref-78429-03-06-2026, me objekt Loti i I-rë: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi rrugës Arben Mekshi dhe Joklin Persi”, me fond limit: 984,993.50 (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, autoriteti kontraktor: Bashkia Tiranës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e protokolluar me shkresën nr. 213 prot., me datë 01.04.2026 protokolluar me tonën me shkresën nr. 846/2 prot, datë 01.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht pranë autoritet kontraktor ka paraqitur shkresë me bojekt “Kërkesë për tërheqje nga shqyrtimi administrativ i ankesës me nr. Aplikimi online A/2026/6427 më datë 14.03.2026, me nr. Ref-78429-03-06-2026, me objekt Loti i I-rë: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi rrugës Arben Mekshi

dhe Joklin Persi”, me fond limit: 984,993.50 (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, autoriteti kontraktor: Bashkia Tiranës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Në nenin 105 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar, dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.

III.1.3. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër ankimimi A/2026/6427, datë 17.03.2026 e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, **Numri i referencës së lotit të I-rë: REF – 78429-03-06-2026**, me objekt: “**Loti i I-rë:** Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtimi rrugës Arben Mekshi dhe Joklin Persi”, me fond limit: 984,993.50 (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 24.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*A & E ENGINEERING*” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtare
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

